

Data: 17/01 /2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: " Përmirësimi i rrjetit fizik dhe wireless, kontrolli i aksesit në rrjet dhe riorganizimi i dhomës teknike KESH Qendër ".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Pajisje të ndryshme -39300000-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: 24,769,000 (Njëzet e katërmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntëmijë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertes nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1.*

**2.Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike:** Sa më sipër.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit.

**Argumentimi:** *Kërkësa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

## **2.3Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 gërma b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë. Është kërkuar që përvoja e ngjashme të jetë në vlerën jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontrates, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në mbështetje të nenit të sipërcituar*

---

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë partneriteti me ofruesin e sistemit dhe produktëve/ Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për shitje dhe suport për sistemin dhe pajisjet që do të furnizojë, e vlefshme në territorin e Shqipërisë.

*Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

**Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme shërben si fakt që siguron se Operatori Ekonomik është në gjendje të ofrojë produktet drejtpërdrejt nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi. Kjo do të çonte në minimizimin e risqeve që mund të vijnë nga mospërmbushja e kontratës nga operatori për shkaqe që lidhen me mardhënien e biznesit midis operatorit dhe prodhuesit të pajisjeve, duke siguruar që kanali i furnizimit është i njohur dhe i autorizuar nga prodhuesi. Operatori Ekonomik duhet të tregojë gjithashtu që gëzon autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi për të shërbyer në sistemet dhe pajisjet që do të instalojë dhe konfigurojë. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara.*

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë zgjidhje teknike e cila duhet të jetë në përputhje të plotë me Termat e Referencës.

*Për plotësimin e këtij kriteri ofertuesi duhet të paraqesë Metodologjinë dhe Planin e Punës si do të realizojë zbatimin në përputhje me Termat e Referencës ku dhe të pranojë realizimin e fazave, sipas mënyrës dhe afateve të Termave të Referencës.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë se pajisjet janë të reja dhe jo të përdorura.

**Argumentim:**

*Këto kërkesa janë vendosur në mënyrë që AK të sigurohet që OE ka studiuar kërkesat teknike dhe ofertën e produkteve specifike për projektin në fjalë. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi cilësinë e produkteve që do të ofrohen.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Menaxhimi i Cilësisë”
- ISO 20000-1:2018 “Menaxhimi i Shërbimeve IT”
- ISO 27001:2013 “Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit”

#### **Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Janë kërkuar këto çertifikata, që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë. Çertifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 20000-1:2018 “Sistemi i menaxhimit të shërbimeve IT”** - Ky standard është i nevojshëm për sigurimin që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem, ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre

**ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”** – Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të ketë në stafin e tij për periudhën Tetor 2022 – Dhjetor 2022 punonjësit të cilët të jenë të çertifikuar si më poshtë:

- a) Minimalisht 1 (një) Menaxher Projekti me arsim të lartë, me çertifikatë PMP (të lëshuar nga PMI) ose ekuivalentin e tij. Me një eksperiencë në punë minimalisht 2(dy) vjeçare.

- b) Minimalisht 2 (dy) specialistë rrjeti të certifikuar në fushën e sigurisë të nivelit profesional ku të paktën njëri të jetë i certifikuar për implementimin e zgjidhjes "Sistem i kontrollit të aksesit" ose ekuivalente, me certifikime nga prodhuesi ose institucione certifikuese të autorizuara nga prodhuesi.
- c) Minimalisht 1 (një) specialist i certifikuar në nivel ëireless professional të dedikuar për implementimin e zgjidhjes "Aksesi radio" ose ekuivalente. Certifikata të jetë e lëshuar nga prodhuesi, ose institucione certifikuese të autorizuara nga prodhuesi.
- d) Minimalisht 2 (dy) specialist të certifikuar për router dhe sëitch, të dedikuar për implementimin e zgjidhjes së rrjetit ose ekuivalente. Certifikatat të jenë të lëshuara nga prodhuesi ose institucione certifikuese të autorizuara nga prodhuesi.
- e) Minimalisht 2 (dy) inxhinier të kualifikuar për konfigurimet e sistemit të monitorimit, sistemit CCTV dhe sistemit të monitorimit të hyrje daljeve nga dhoma teknike, të certifikuar nga prodhuesi/t përkatës ose autoritete certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t si.
- f) Minimalisht 1 (një) inxhinier elektrik të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, për të garantuar sigurinë gjatë punës.
- g) Minimalisht 1 (një) inxhinier, të specializuar për instalimin e sistemit te ftohjes dhe dedektim/shuarje zjarri, të certifikuar nga prodhuesi/t përkatës ose autoritete certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t.
- h) Minimalisht 2 (dy) specialistë të kualifikuar për kabllimet sipas kërkesave praktike të instalimit, që do të jenë përgjegjës për të gjitha kabllimet në dhomë. Specialistët duhet të jenë të certifikuar nga institucionet kompetente kombëtare/ndërkombëtare, nga prodhuesi/t përkatës të sistemeve që do të instalohen ose nga autoritetet certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Certifikatat e mësipërme të vlefshme,
- Diploma
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Tetor 2022 – Dhjetor 2022

## **Argumentim:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

## **Në lidhje me punonjësit e mësipërm argumentojmë si më poshtë:**

**Minimalisht 1 (një) Menaxher Projekti me arsim të lartë, me certifikatë PMP:** *Për të siguruar mbarëvajtjen e kontratës nga aspekti i menaxhimit të projektit me cilësi dhe në përputhje me standartet dhe bazuar në metodologji botërore, OE duhet të ketë në dispozicion të kontratës një punonjës të certifikuar në fushën e Menaxhimit të Projekteve. Eksperti garanton Autoritetin Kontraktor se stafi menaxherial i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohurit dhe ekspertizën e duhur profesionale për menaxhimin e kontratës objekt i kesaj procedure. Niveli i kërkuar profesional, arsimimi dhe eksperiencia e kërkuar garanton profesionalizem dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës.*

**Minimalisht 2 (dy) specialistë rrjeti të certifikuar në fushën e sigurisë të nivelit profesional:** *Këta specialist janë kërkuar bazuar në termat e referencës ku janë parashikuar mallrat, vendosja dhe zgjidhja teknike mbi komunikimin e kontrollit të aksesit. Këta punonjës do të bëjnë të mundur implementimin dhe dhënien e zgjidhjes teknike për këtë sistem. Çertifikimi është i domosdoshëm për të vërtetuar aftësitë profesionale të implementuesit.*

**Minimalisht 1 (një) specialist i certifikuar në nivel ëireless profesional të dedikuar për implementimin e zgjidhjes "Aksesi radio" ose ekuivalente:**

*Specialist i certifikuar në nivel ëireless professional të dedikuar për implementimin e zgjidhjes "Aksesi radio" ose ekuivalente, është kërkuar bazuar në termat e referencës. Specialisti do të bëjnë të mundur implementimin dhe dhënien e zgjidhjes teknike për këtë sistem. Ku zgjidhja teknike duhet të mundësojë provizionim të qendëruar të pikave të aksesit radio, duhet të mundësojë funksionet e sigurisë së kërkuar etj. Çertifikimi është i domosdoshëm për të vërtetuar aftësitë profesionale të implementuesit.*

**Minimalisht 2 (dy) specialist të certifikuar për router dhe switch, të dedikuar për implementimin e zgjidhjes së rrjetit ose ekuivalente:**

*Këta specialist janë kërkuar bazuar në termat e referencës ku janë parashikuar mallrat, vendosja dhe zgjidhja teknike mbi komunikimin e kontrollit të aksesit. Këta punonjës do të bëjnë të mundur implementimin dhe dhënien e zgjidhjes teknike për këtë sistem pasi sistemi i sigurisë në rrjet dhe ai i wireless kërkon ndërhyrje në paisjet kryesore router the switch. Për parsojë për te shmangur ndërhyrje të pa certifikuara dhe duke cënuar kështu rrezikshmerinë nga ndonjë gabim në*

*konfigurime kërkohet ky certifikim i domosdoshëm për të vërtetuar aftësitë profesionale të implementuesit. Kryesisht KESH perdor routera dhe switch të brand-eve të mirë njohura si CISCO dhe HP.*

**Minimalisht 2 (dy) inxhinier të kualifikuar për konfigurimet e sistemit të monitorimit, sistemit CCTV dhe sistemit të monitorimit të hyrje daljeve nga dhoma teknike:**

*Për arsye se do të ndërhyet në sistemet e aksesit të kontrollit dhe sistemit ekzisues të vëzhgimit me kamera sigurie, nevojitet ekspertizë e posaçme për të adaptuar ndryshimet sipas kushteve të këtij projekti. Për rrjedhojë, kërkohen të paktën 2 inxhinierë të tillë, në mënyrë që të shërbejnë edhe si backup i njeri tjetrit për të minimizuar risqet e mundshme të disponueshmërisë së stafit të specializuar dhe për të mos cënuar ecurinë e punës, kriter i cili do të vërtetojë aftësitë e kompanisë së kontraktuar për të përmbushur nevojat e KESH.*

**Minimalisht 1 (një) inxhinier elektrik të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, për të garantuar sigurinë gjatë punës.**

*Për punimet elektrike të cilat do të kryhen gjatë zbatimit të kontratës, kërkohet të paktën 1 (një) inxhinier elektrik, i cili duhet të jetë i pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik do të garantojë sigurinë teknike gjatë zbatimit të punimeve të instalimit të pajisjeve. Gjithashtu duke parë kompleksitetin e paisjeve të instaluara mund të lind nevoja e ndërhyrjeve në rrjetin elektrik për të akomoduar spostimet e kërkua nga stafi i KESH.*

**Minimalisht 1 (një) inxhinier, të specializuar për instalimin e sistemit të ftohjes dhe dedektim/shuarje zjarri:**

*Sipas kushteve të termave të references, kërkohet adaptimi i sistemit të kondicionimit ekzistues në dhomën e paisjeve dhe spostimi i këtij sistemi për të përballuar zgjerimin e infrastrukturës. Për të realizuar këtë aktivitet kërkohet një inxhinier i specializuar. Inxhinieri specialist dhe certifikuar për instalimin e sistemit të ftohjes dhe dedektim/shuarje zjarri, garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i kualifikuar dhe ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës. Specialisti garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për menaxhimin e teknologjisë objekt i kësaj procedure. Niveli i kërkuar profesional, arsimimi dhe eksperiencia e kërkuar garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës.*

**Minimalisht 2 (dy) specialistë të kualifikuar për kabllimet sipas kërkesave praktike të instalimit, që do të jenë përgjegjës për të gjitha kabllimet në dhomë.**

*Projekti ka qëllim gjithashtu riorganizimin e kabllimeve në dhomën e paisjeve. Kjo për arsye të sistemit visual gjithashtu edhe për të thjeshtuar punën e specialisteve dhe stafit të DATIK të cilët mirëmbajnë këto sisteme. Kërkohen të paktën 2 specialistë të tillë, në mënyrë që të shërbejnë edhe si backup i njëri tjetrit për të minimizuar risqet e mundshme të disponueshmërisë së stafit të*

*specializuar dhe për të mos cënuar ecurinë e punës. Këta specialist duhet të jenë të certifikuar për kabllimet, nga institucionet kompetente kombëtare/ndërkombëtare, nga prodhuesi/t përkatës të sistemeve që do të instalohen ose nga autoritetet certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t, garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i kualifikuar dhe ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës. Specialisti garanton Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për menaxhimin e teknologjisë objekt i kësaj procedure. Niveli i kërkuar profesional, arsimimi dhe eksperiencia e kërkuar garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara për realizimin e kontratës. Numri i specialisteve të kërkuar është vlerësuar të jetë të paktën 2, për të shmangur cdo risk të mundshëm që vjen si pasojë e mungesës së disponibilitetit të njërit prej specialistëve, duke patur një specialist mbështetës.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### ***Shenim:***

*Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose terësinë e elementëve më të rëndësishme përbërese, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar cdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe cdo standard të kërkuar, ku cdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### ***Kujdes:***

*Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i vecante, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e pershkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*”.*

Qëllimi kryesor i këtij projekti është zëvendësimi i infrastrukturës aktuale wireless me një infrastrukturë wireless të re bazuar mbi teknologjinë WIFI-6, e cila do të mundësojë performancë më të mirë, kapacitet të lartë dhe funksione të reja duke ofruar një eksperiencë më të mirë për përdoruesit e rrjetit Wireless.



Përveç përmirësimit të rrjetit Wireless, do të realizohet edhe implementimi i platformës së menaxhimit të Sigurisë së Identitetit në Rrjet, e cila është një platformë e nevojshme për të thjeshtuar menaxhimin e politikave të sigurisë.

Kjo platformë do të sigurojë qasje shumë të sigurt në rrjet për përdoruesit dhe pajisjet, si dhe do të ndihmojë për të patur shikueshmëri në atë që po ndodh në rrjetin e KESH, aktivitete të tilla si kush është i lidhur, cilat aplikacione janë të instaluar dhe janë në funksion etj. Gjithashtu siguron të dhëna kontekstuale të rëndësishme, të tilla si identiteti i përdoruesit dhe pajisjes, kërcënimet dhe vulnerabilitetet të cilat mund të identifikohen, monitorohen dhe korrigjohen në një kohë me të shkurter.

Tjetër qëllim i projektit është si më poshtë:

- Lirim i hapësirave në dhomën ekzistuese të serverave, në mënyrë që të lejoje shtimin e rack dhe paisjeve të reja. Momentalisht është e pamundur që në dhomën e serverave të shtohet një rack i ri për vendosjen e paisjeve të reja.
- Riorganizim i rack-ve ekzistues në server room, në mënyrë që të rritet efica e sistemit të ftohjes, e cila automatikisht përkthehet në më pak konsum energjie elektrike.
- Sistemimi i paisjeve nëpër racke dhe etiketimin e tyre, për të lehtësuar operimin, mirëmbajtjen dhe ndryshimet që mund të nevojiten.
- Sistemimi i kabllimeve nëpërmjet rackeve, lidhja e paisjeve me patch corda baker (ethernet) dhe fiber optike me patch panelet përkatëse, si edhe etiketimet e të gjitha patch cordave, për të lehtësuar operimin, mirëmbajtjen dhe ndryshimet që mund të nevojiten.
- Ndarje në dy ambjente të dedikuara të pajisjeve IT dhe pajisjeve teknike në server room duhet të jene të instaluar vetem pajisjet IT (servera, storage, pajisje telekomunikacioni), ndersa në dhomen teknike duhet të jene të instaluar sistemet teknike që garantojne kushtet operationale të pajisjeve IT.

## **Njësia e Prokurimi**